



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 29.01.2019
(Dokument parlamentar)

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES STATUSORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, MBI VEPRIMET E NDËRMARRA NGA AGJENCIA E ROJES BREGDETARE DHE KUFIRIT EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 28.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojes Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Xhemal Qefalia.

Për të bërë prezantimin e marrëveshjes në komision morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, “Mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i bashkëpunimit në fushën operacionale, për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar si dhe kryerjen e operacioneve të kthimit e të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve. Kjo marrëveshje do t'i hapë rrugë bashkëpunimit në fushat e shkëmbimit të informacionit, analizës së riskut, trajnimit, kërkimit, zhvillimit të projekteve pilot, dhe operacioneve të përbashkëta.

Kjo marrëveshje synon:

-ritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe emigracionit të paligjshëm si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit e ripranimit;

- pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime;

- ritjen e nivelit profesional të punonjësve të policisë së shtetit dhe përcaktimin e detyrave e të kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave;

- ritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit si dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike e logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme të flukseve të mëdha migratore, të papërballueshme me kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 83, 121 e 155 të Kushtetutës, dhe në harmoni me ligjin nr.43/2016 “ Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë ”

- ***Diklutime në Komision***

Gjatë diskutimeve në komision, zëvendësministrja Znj. Voda në fjalën e saj theksoi rëndësinë e kësaj marrëveshjeje , nënshkrimi i së cilës qënë edhe një nga detyrat e Shqipërisë në kuadër të procesit të hapjes së negociatave për antarësim në Bashkimin Europian dhe në kuadër të kapitullit 2. FRONTEX, është një agjenci e cila promovon, koordinon dhe zhvillon menaxhimin e integruar të kufirit në linjë me të drejtat themelore të Bashkimit Europian dhe në linjë me konceptin e menaxhimit të integruar të kufijve. Ajo është krijuar për të vepruar si agjenci brenda vendeve të BE-së, por me rregulloren e re të FRONTEX duke e zgjeruar edhe veprimtarie e kësaj agjencie është parë si një element kyç i saj edhe bashkëpunimi operacional me vendet e treta që nuk janë pjesë e bashkimit evropian.

Në vijim Znj.Voda shpjegoi edhe detyrat e Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian e cila :

-do të ndihmojë në inkurajimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit teknik dhe operativ ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta dhe krijon mundësinë e bashkëpunimit me vendet e treta;

-koordinojë në kuadrin e bashkëpunimit operacional në lidhje me menaxhimin e kufijve të jashtëm ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta;

-ajo mund të kryejë aksione në kufijtë e jashtëm, që përfshijnë një ose më shumë shtete anëtare dhe një vend të tretë, i cili është fqinj me, të paktën, një prej këtyre shteteve anëtare. Ky i jep mundësi agjencisë të ndihmojë edhe vendin tonë në menaxhimin e kufijve dhe të flukseve të migracionit; në lidhje me operacionet e kthimit, mund të organizojë ose koordinojë këto operacione në përputhje me dispozitat e Direktivës së Kthimit 2008/115/EC. Të gjitha operacionet do të kryhen mbi bazën e një plani operacional. Planin operacional do të dakordësohet nga shteti anëtar ose shtetet anëtare, që kufizojnë zonën operationale, dhe vendit të tretë.

Mandej znj. Voda shtoi se Shqipëria është vendi i parë nga vendet e Ballkanit Perendimore që ka finalizuar këtë marrëveshje e cila do të jetë një vlerë e shtuar për vendin tonë përse i përket rritjes së sigurisë kufitare me vendet e BE-së me të cilat ajo ndan kufijtë.

Pas relatimit të z. Qefalia si dhe nga diskutimet e bëra nga anëtarët e komisionit u vlerësua kjo nisëm, e cila i lejon shtetit shqiptar dhe perkatësisht rojes bregdetare që të bashkeveproje me Agjensinë Europiane për Rojen Bregdetare dhe Kufirin në mbrojtjen e kufirit dhe njëkohësisht në përballimin e të gjitha fenomeneve që lidhen me migracionin e paligjshëm dhe operacionet që kanë të bëjnë me të sic janë ato të rikthimit apo të pranimi të migrantëve.

- ***Përfundime***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

KRYETARE

XHEMAL QEFALIA

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)